



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGJENCIA PROTIV KORUPCIE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGJENCIA PROTIV KORUPCIE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK  
Nr. Prot. 01-4018/12  
Br. Prot.  
Prot No.  
Nr. i faq. 02  
Broj stranica  
Datum 07-11-2012  
Date  
PRISHTINË

<b>DATË/A:</b>	07.11.2012
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Sadri Emerllahu u.d i Drejtorit i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Drejtësisë
<b>CC:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me tenderin “Larja e Automjeteve për Institucionet e Ministrisë së Drejtësisë”



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “Larja Automjeteve për Institucionet e Ministrisë së Drejtësisë ” me numër prokurimit 21500-12-035/A-221 ofron këtë:

**OPINION**

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimit e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Larja Automjeteve për Institucionet e Ministrisë së Drejtësisë” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

**A r s y e t i m**

Zyra e prokurimit në Zyrën e Ministrisë Drejtësisë, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit “Shërbime ” të procedurës së hapur kontrata publike kornizë me një Operator Ekonomik me nr. prokurimi 21500-12-035/A-221 me titull tenderi “Larja Automjeteve për Institucionet e Ministrisë Drejtësisë ” në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit (FDT) te neni 9.1 i Dosjes së

tenderit te Kërkesat mundësitë teknike dhe /ose profesionale pika 3 Dokumentet e Kërkuara – ka kërkuar që Largësia – distanca nga parkingu i objektit qeveritar ish “Rilindja” duhet të jetë përafërsisht deri në 2.5 km ( dy kilometra e gjysmë) nga kjo rrjedh se departamenti i prokurimit ka bërë diskriminim territorial gjë që paraqet shkelje të nenit 7 pika 4 LPP-së 04/L-042.

Më datë 05.11.2012 komisioni vlerësues i formuar nga A.K ka dalë në vende të ngjarjes dhe ka bërë matjen e të gjitha selive të O.E dhe erdhi në përfundim se O.E “ Bush Geu” – Prishtinë kishte selinë e vetë më larg se 2.5 km d m th afërsisht 3km gjë që ketë O.E komisioni vlerësues e ka shpallur të pa përgjegjshëm.

Zyra e prokurimit në Ministrin e Drejtësisë, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit te Seksioni II Fleta e të dhënave të tenderit (FDT) (Periudha e Vlefshmërisë së tenderit pika 21.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 90 ditë, te PJESA C, Formulari i dorëzimit të tenderit te pika 4 ka plotësuar validitetin e ofertës për një periudhë prej 60 ditë nga data finale për dorëzimin e tenderit gjë që nuk është në përputhje me **nenin 20** Rregullores për Prokurim Publik ngase këtë pikë duhet plotësuar Operatoret Ekonomik.

Me respekt!

